

STATUTI

I SHOQERISE TREGTARE
“TRADINGOIL ALBANIA” sh.p.k.

I. HYRJE

I.1 Shoqeria tregtare me perjegjesi te kufizuar “**TRADINGOIL ALBANIA**” sh.p.k., qe nga ky moment dhe me pas referohet si shoqeri e cila krijohet mbi bazen e iniciatives dhe kapitalit personal te ortakut te vetem :

1. *Antonio Carboni, i biri i Alberto-s, i datelindjes 14.07.1965, lindur ne Minturno, Itali dhe banues Residente, Via Abate Stefano n.5, Serravalle 47899, San Marino RSM me pasaport nr.YA9137535 dhe dokument 100243437 ;*

I.2 Shoqeria krijohet dhe zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me normat ketij statuti si dhe te legjislacionit te Republikes se Shqiperise.

I.3 Kjo shoqeri, si shoqeri me perjegjesi te kufizuar, i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit te saj themeltar.

II. OBJEKTI

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne :

- *Import eksport, perpunim, dhe tregtimin me shumice dhe pakicë te hidrokarbureve, te naftës, gazit dhe nënprodukteve te tyre, te vajrave lubrifikante, lëndëve djegëse, likuide të ndryshme, etj. ;*

- *Studim, projektim, ndërtim, te paneleve dhe centraleve për prodhimin e energjisë elektrike nga burime hidrike dhe të rinotüeshme nëpërmjet paneleve dhe parqeve fotovoltaikë, hidrike dhe eolike ;*

- *Prodhim, transmetim, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike së prodhuar nga burime të rinotüeshme nga burimet diellore, të erës apo hidrike dhe ofrimin e sherbimeve të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara përvete ose për llogari të palëve të treta ;*

- *Import eksport dhe tregtim te mallrave te ndryshem, bujqesor, industriale, materiale ndertimi si dhe transportin e tyre per vete dhe per te trete ;*

- *Projektim, investime ne ndertime civile, industriale dhe ne fushen turistike, ne fushen agroturizemit duke perfshire dhe veprimtarite ne fushen e strukturave akomoduese hoteleri, bar restorant etj. ;*

- *Ofrimin e sherbimeve te konsulences dhe ndermjetësimit, agjenci imobilare per shitje dhe blerje te te gjitha llojeve te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme.*

- *Shoqeria per realizimin e objektit te veprimitarise se saj, bashkepunon dhe ndermjeteson, me persona juridik e fizik, qe kane te njejtin objekt veprimitarie ose te ngashhem me te ;*

III. EMRI, SELIA, TERRITORI.

III.1 Kjo shoqeri me perjegjesi te kufizuar do te quhet “**TRADINGOIL ALBANIA**”sh.p.k.



III.2 Shoqeria do te fitoje personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit.

III.3 Shoqeria do te kete *seline e saj ne, Lagja nr.3, Rruga Egnatia, Zona Kadastrale nr.8514, me nr.Pasurie 4/280-N11, Durres*, ku do te zhvillohet aktiviteti i saj kryesor ekonomik.

III.4 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

III.5 Shoqeria mund te krijoje dege te tjera edhe ne rrethe te tjera te vendit.

IV. KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

IV.1 Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i ortakut te vetem te shoqerise, ne shumen prej 1.000.000 (nje milion) leke. Pjesemarria e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje te plete me kontributet e tyre, sa me poshte :

1. Ortaku themelues *Antonio Carbone*: Zoterues i 1(nje) kuote, me vlore te pergjithshme 1.000.000 (nje milion) leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise "TRADINGOIL ALBANIA" sh.p.k. ;

IV.2 Kapitali themeltar do te depozitohet ne nje nga bankat, para fillimit te aktivitetit te shoqerise.

IV.3 Kapitali themeltar mund te shtohet ose te zvogelohet ne varesi te rezultateve dhe nevojave ne perputhjeve me dispozitat e legjislacionit ne fuqi.

IV.4 Kapitali themelor mund te trasferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi.

IV.5 Kapitali themeltar eshte lirisht i trasferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, me vendim te ortakeve dhe ne baze te legjislacionit ne fuqi.

V. FONDET E SHOQERISE

V.1 Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

a-Fondi themelor (qarkullues).

b-Fondi rezerve

c-Fonde te tjera, te cilat mund te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

V.2 Masa e secilit fond dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen me vendim te organit drejtues te shoqerise.

VI. ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

VI.1 Organ i vetem drejtues i shoqerise eshte, *Asambleja e ortakeve*, si organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe merr vendime me shumice te cilesuar $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, si :

- ndryshimet ne statutin e shoqerise ;
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit ;
- shperndarjen e fitimeve ;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise ;

VI.2 Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakteve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise ;
- emerimin dhe shkarkimin e administratoreve ;
- emerimin dhe shkarkimin e likujdusve dhe eksperteve kontabel ;

- mbikqyrjen dhe zbatim e politikave tregtare nga administratoret perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore ;

- çeshtje te tjera te parashikuara ne ligj dhe ne statutin e shoquerise ;

VI.3 E gjithe veprimitaria e shoquerise percaktohet dhe drejtohet nga administratori i saj ne perputhje me legjisacionin ne fuqi. *Administrator i kesaj shoquerie emerohet Z. Antonio Carbone i datelindjes 14.07.1965, lindur ne Minturno, Itali dhe banues Residente, Via Abate Stefano n.5, Serravalle 47899, San Marino RSM me pasaport nr.YA9137535 dhe dokument 100243437, me nje afat 5-vjecar me te drejte riemerimi.*

VI.4 Per administrimin e shoquerise ose te aktiviteve te vecanta te saj, administratori mund te emeroje nje ose disa administratore te mundshem.

VI.5 Kompetencat e administratoreve te mundshem, ne menyre te pergjithshme percaktohen ne statut dhe detajohen e konkretizohen ne aktin e tyre te emerimit.

VI.6 Shoqueria nuk merr persiper, veprimet e ndryshme te mundshme te administratorit te mundshem ne marredhenie me te tretet, te cilat i tejkalojne kompetencat e tij te percaktuara ne statut dhe ne aktin e emerimit.

VI.7 Asambleja e ortaveke per te shqyrtuar bilancin vjetor, te ardhurat e qarkulluara si dhe menyren e mbajtjes se regjistrat te veprimeve kontabile emeroni, nje ose disa ekspert kontabel.

VI.8 Emertimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara me ligj.

VII. KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit " Per Tregtaret dhe Shoquerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo me mjete elektronike, sipas nenit 88, pika 3, e Ligjit.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te kuorumit te permendur me lart, ajo mund te therritet per tu mbledhur perseri jo me vone se 30 dite, me te njejten rend dite

VIII. KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen :

1. Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoquerise, duke zbatuar politkat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
2. Te perfaqesoje shoquerine tregtare me te trete ;
3. Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoquerise ne perputhje me legjisacionin ne fuqi ;
4. Te pergatisin dhe te nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumenta perpara asanblese se pergjithshme per miratim ;
5. Te kryejne rregjistrimet dhe te dergojne te dhenat e detyrueshme te shoquerise sic parashikohet ne Ligjin per QKR ;
6. Te kryeje edhe detyra te tjera te percaktuara ne Ligj dhe ne statut ;



IX. KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT TE MUNDSHEM

Kompetencat e plota e administratorit te mundshem, percaktohen ne aktin e emerimit te tij. Vec te tjerave qe mund te percaktohen ne kete akt, administratori i mundshem ka edhe keto kompetencia:

IX.1 Kujdeset per funksionimin e perditshem dhe normal te aktivitetit ekonomik dhe financiar te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi dhe ja paraqet per shqyrtim administratorit.

IX.2 Pergatit dokumentacionin dhe relacionet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi dhe ja paraqet per shqyrtim administratorit.

IX.3 Koordinon veprimtarine e personelit te punesuar ne shoqeri.

IX.4 Shqyrton oferta dhe pergaatit kontrata, te cilat ja paraqet administratorit per miratim.

VIII.5 Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organe te ndryshme shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

IX.6 I propozon administratorit, cmimet e shitjes dhe te sherbimeve si dhe per pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.

IX.7 I propozon administratorit rregulloret per sektore te vecante te veprimtarise se shoqerise.

X. NDARJA E FITIMIT

X.1 Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, pagave te punonjesve etj., ortakeve i mbetet ne dispozicion, fitimi neto.

X.2 Fitimi neto, mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltar, per shtimin e tij me kapital ne natyre, per shtimin e fondev te shoqerise, e tjera.

X.3 Fitimi neto mund te perdoret dhe per qellime te tjera.

XI. KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kjo shoqeri krijohet per nje afat te pacaktuar.

XII. MENYRA E PERFAQËSIMIT TE SHOQERISE

XII.1 Shoqeria perfaqeshet nga administratori i saj, ne te gjitha marredheniet e ndryshme juridike.

XII.2 Ajo mund te perfaqësohet dhe nga ndonje person tjeter i pajisur me prokure te posaçme ose me autorizim te veçante.

XIII. MARREDHENIET E PUNESIMIT

XIII.1 Çdo person i punesuar ne shoqeri, duke perfshire dhe administratorin e mundshem, konsiderohet si i tille mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit te shoqerise ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

XIV. PERGJEGJESIA E PUNONJESVE DHE KONFIDENCIALITETI

XIV.1 Çdo person i caktuar si administrator i mundshem, ose i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te ruaje karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informacionit, te pervojes se shkembyer si dhe te cdo materiali tjeter

konfidencial. Ai eshte gjithashtu i detyruar te permbushe te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes si dhe nga vendimet e administratorit.

XV. MBARIMI I SHOQERISE

XV.1 Veprimataria e shoqerise mbaron me vendim te organit te saj drejtues, ne rast se aktiviteti i saj nuk rezulton fitim prures, per shkak te forces madhore si dhe per shkaqe te tjera ligjore.

XV.2 Shoqeria mund te mbaroje dhe me ane te riorganizimit, nepermjet formave te thithjes e te bashkimit.

XV.3 Gjate fazes se likuidimit te shoqerise, administratori, administratori i mundshem dhe eksperti kontabel kane te njejtin perqejegesi.

XVI. DISPOZITA TE FUNDIT

XVI.1 Viti finanziar i shoqerise fillon me 1(nje) janar dhe perfundon me 31(tridhjete e nje) dhjetor.

XVI.2 Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne Institutet e Sigurimeve te Shqiperise.

XVI.3 Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohen nga administratori i saj.

XVI. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky statut u miratua nga ortaket e shoqerise, sot me date, 02/08/2023.

**ORTAKU I VETEM
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TRADINGOIL ALBANIA”**

Antonio CARBONE

